3.3.3 The execution and delivery of and performance by Norfund of this Agreement, compliance with the conditions set forth herein and the realization of the transaction contemplated hereunder do not and will not, in all material respects, result in a breach or default, and do not and will not create a situation of fact which, after notice and/or the passing of time, will result in a breach or default, and are not and will not be incompatible with respect to any provision of the constituting documents of Norfund or any contract, agreement or other instrument to which Norfund is a party or by which it is contractually bound so as to affect the validity of the obligations of Norfund hereunder; or with respect to any law applicable to Norfund;

3.3.4 Norfund complies with all the laws and regulations relevant to Norfund's holding of the Norfund Shares including those relating to environmental and social (ESG), Bank of Albania, and any other applicable laws and regulations;

3.3.5 Norfund has disclosed full and accurate information to the Company, in relation to the transaction under this Agreement.

4. Miscellaneous

5.1 If it becomes necessary or useful to give notice hereunder, such notice shall be given in writing, sent by registered or certified mail or personally delivered or transmitted via email to the addresses indicated below. If notice is given by registered or certified mail, it shall be deemed to have been received three (3) business days after the date it is mailed, unless evidence of earlier delivery. In the case of delivery by messenger or by hand, such notice shall be deemed to have been received on the same day.

With respect to Norfund:

Fridtjof Nansens plass 4

0160 Oslo

Norway

Attention: Marianne Halvorsen, marianne.halvorsen@norfund.no

With a copy to: Jo Løchen, jo.lochen@norfund.no

With respect to HELENOS:

Avenue Jules César 2 box 7 – 1150 Brussels – Belgium
Attention: Nicolas Blondeau, Manager
nicolas.blondeau@inpulse.coop

With a copy to: Izabela Norek, Investment Manager
izabela.norek@inpulse.coop
reporting.helenos@inpulse.coop

With respect to the Company:

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k., Rruga "Bardhok Biba", Gd. Vjeter Tirana,
Hyrja 1, Kati 2, Tirane, Shqiperi

Attention: Dorin Rama, Executive Director


Dorin.rama@crimsoncapital.org

- 5.2 All documents to be furnished or communications to be given or made under this Agreement shall be in the English language or, if in another language, shall be accompanied by a translation into English, which translation shall be the governing version between the Parties.
- 5.3 This Agreement shall be governed by and construed in accordance with Albanian law. Any dispute, controversy or claim arising out of or in connection with this Agreement, or the breach, termination or invalidity hereof, shall be finally settled by arbitration in Oslo in accordance with the Rules of the Arbitration and Dispute Resolution Institute of the Oslo Chamber of Commerce in force at any time.
- 5.4 This Agreement may be executed in any number of counterparts, each of which shall be deemed an original and enforceable against the Parties actually executing such counterpart, and all of which together shall constitute one and the same instrument.
- 5.5 This Agreement is executed in English language, with a convenient translation in Albanian language. The English language version shall constitute the binding version between the Parties.

IN WITNESS WHEREOF, the Parties hereto, acting through their duly authorised representatives, have caused this Agreement to be signed in their respective names as of the date first above written.

The Norwegian Investment Fund for Developing Countries

Legally represented by
Marianne Halvorsen
Senior Investment Manager




HELENOS

Legally represented by
Ms. Laurence Chambrey, spouse May
Risk and Compliance Manager




Nicolas Blondeau
Manager



CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA SEPK

CEO and Administrator
Mr. Dorin Rama





IN WITNESS WHEREOF, the Parties hereto, acting through their duly authorised representatives, have caused this Agreement to be signed in their respective names as of the date first above written.

The Norwegian Investment Fund for Developing Countries
Legally represented by
Marianne Halvorsen
Senior Investment Manager



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Marianne Halvorsen", written over a horizontal line.

HELENOS
Legally represented by
Ms. Laurence Chambrey, spouse May
Risk and Compliance Manager

Nicolas Blondeau
Manager

CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA SHPK
CEO and Administrator
Mr. Dorin Rama

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Dorin Rama", written over a horizontal line.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LORIANA A. ROBO



V2022050250331763444

DATE 04/08/2022
NR REP 3984

VËRTETIM NJESIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 04.08.2022, para meje Noterit LORIANA A. ROBO, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

KËRKUESI:

Majlinda Gecaj, atësia Fran, amësia Shpresa, shtetase Shqiptare, lindur në Bajram Curri, Tropojë dhe banuese në Tiranë, me adresë Gjergj Legisi; Nd. 072; H. 1; Njësia Administrative Nr. 11; Njësia Bashkiake Nr. 11; 1031; Tiranë, lindur më 25/06/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035669808 dhe nr. personal J85625063G, e cila paraqiti origjinalin e dokumentit ne vijim:

- Marrëveshja e transferimit të aksioneve ndermjet NORFUND dhe HELENOS ne lidhje me "Crimson Finance Fund Albania" Shpk.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjës në rast paraqitje të dokumentit të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
LORIANA A. ROBO



DUBLIN
VIRIA

MARRËVESHJE PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE



ndërmjet

FONDIT NORVEGJEZ TË INVESTIMIT PËR VENDET NË ZHVILLIM

dhe

HELENOS

Në lidhje me

"CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA" SHPK



MARRËVESHJE PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE

Kjo marrëveshje për transferimin e kuotave ("Marrëveshja") lidhet më 01/08/2022, ndërmjet:

FONDIT NORVEGJEZ TË INVESTIMIT PËR VENDET NË ZHVILLIM, një subjekt ligjor i themeluar sipas ligjeve të Norvegjisë, i regjistruar në Norvegji, me numër unik identifikimi 879 554 802, me seli në Norvegji, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i autorizuar Znj. Marianne Halvorsen, shtetase norvegjeze, lindur në Oslo, më 26.06.67, mbajtëse e pasaportës nr. 31308645, ("Norfund"),

dhe

HELENOS, një "pricaf privee"/ "private privak", në formën e një "societe anonyme"/"naarnloze vennootschap", një shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Belgjikës, me adresë të regjistruar në avenue Jules Cesar 2, box 7, 1150 Woluwe Saint Pierre, Belgium, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare me numër unik identifikimi 0700 505 789, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj të autorizuar rregullisht Laurence Chambrey, spouse May, Menaxher i Riskut dhe Pajtueshmërisë, shtetas francez, lindur në Tubingen, më 15 Qershor 1964 dhe mbajtës i pasaportës nr. 22DF25620 dhe Nicolas Blondeau, Administrator, shtetas belg, lindur në Etterbeek, më 13 Gusht 1976 dhe mbajtës i pasaportës nr. EP580344 ("**Investitori**" ose "**HELENOS**");

dhe

"CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA" SHPK, një institucion financiar jo-bankë, i themeluar rregullisht sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me numër unik identifikimi (NUIS) L51307031A, me seli në Rruga Bardhok Biba, Gd. Vjetër Tiranë, Hyrja I, Kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar rregullisht nga Drejtori i saj Ekzekutiv dhe Administratori z. Dorin Rama, shtetas shqiptar, lindur më 28.07.1990 dhe mbajtës i pasaportës me numër identifikimi J00728080T ("**Shoqëria**" ose "**CFFA**");

Norfund dhe HELENOS dhe CFFA në vijim referohen individualisht si "**Pala**" dhe bashkërisht si "**Palët**".

MEQENËSE:

- (A) Në datën e kësaj Marrëveshjeje, kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë zotërohet nga ortakët e mëposhtëm ("Ortakët Ekzistues"):
1. Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) zotëron një kuotë që përbën 32.02% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 114,366,910.00 Lekë;
 2. Bashkia e Tiranës zotëron një kuotë që përbën 25.68% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 91,721,985.00 Lekë;
 3. Fondi Norvegjez i Investimit për Vendet në Zhvillim zotëron një kuotë që përbën 20.99% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 74,952,500.00 Lekë ("Kuotat e Norfund");
 4. Crimson Capital Corp zotëron një kuotë që përbën 3.85% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 13,750,000.00 Lekë;
 5. HELENOS zotëron një kuotë që përbën 17.46% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 62,379,649.00 Lekë;
- (B) Ortakët Ekzistues përmes vendimit unanimit të datës 01/08/2022 ("Vendimi"), kanë rënë dakord që (i) Kuotat e Norfund mund të transferohen tek HELENOS dhe se (ii) Ortakët Ekzistues ndër të tjera heqin dorë nga çdo e drejtë parablerjeje që mund të gëzojnë sipas ligjit ose sipas kontratës, për blerjen e Kuotave të Norfund si rezultat i kësaj Marrëveshjeje i transferimit ose transferimit të parashikuar të Kuotave të Norfund tek HELENOS;
- (C) Në zbatim të kushteve të kësaj Marrëveshjeje, HELENOS me vendim të komitetit të saj të investimit datë 19 Nëntor 2021 ka miratuar dhe ka rënë dakord të marrë në zotërim Kuotat e Norfund përkundrejt çmimit ekuivalent me vlerën e regjistruar prej 74,952,500.00 lekë ose ekuivalent me 612,000 EUR.
- (D) Palët kanë për qëllim që ortakët e Shoqërisë në përfundim të transaksionit të mësipërm të zotërojnë kuotat e emetuara në Shoqëri sipas pjesëve takuese si më poshtë:
- 1) Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) zotëron një kuotë që përbën 32.02% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 114,366,910.00 Lekë;
 - 2) Bashkia e Tiranës zotëron një kuotë që përbën 25.68% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 91,721,985.00 Lekë;
 - 3) Crimson Capital Corp zotëron një kuotë që përbën 3.85% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 13,750,000.00 Lekë;

- 4) HELENOS zotëron një kuotë që përbën 38.45% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë të regjistruar prej 137,332,149 Lekë;

PËR KËTË ARSYE Palët bien dakord si më poshtë:

1. Hyrje, Përkufizime, Interpretimi

- 1.1 Të gjitha deklaratimet hyrëse janë pjesë përbërëse dhe e konsiderueshme e kësaj Marrëveshjeje.
- 1.2 Çdo gjini që përmendet në këtë Marrëveshje përfshin edhe të gjitha gjinitë e tjera, dhe fjalët në numrin njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe e kundërta, përveç nëse përcaktohet ndryshe.
- 1.3 Ndarja e kësaj Marrëveshjeje në paragrafë, nënparagrafë, nene dhe nënndarje të tjera, si dhe vendosja e titujve, bëhet vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikon ose nuk përdoret në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Objekti i kësaj Marrëveshjeje dhe kushtet e nënshkrimit

- 2.1 Sipas dhe në zbatim të kushteve kësaj Marrëveshjeje, Norfund transferon kuotat e Norfund tek HELENOS përkundrejt pagesës nga HELENOS të çmimit ekuivalent me vlerën e regjistruar të Kuotave të Norfund prej 74,952,500.00 lekë ose ekuivalentit prej 612,000 euro (“Çmimi”)
- 2.2 Palët bien dakord se pagesa do të kryhet nga HELENOS drejt Norfund brenda 90 ditëve nga data e miratimit të transferimit të Kuotave të Norfund nga Banka e Shqipërisë. Në rast se kjo nuk ndodh brenda afatit maksimal të rënë dakord,
 - 2.2.1 Norfund mund ta deklarojë këtë Marrëveshje të pavlefshme, dhe
 - 2.2.2 Norfund mund të anulojë transferimin e kuotave tek HELENOS dhe të bëjë të gjitha njoftimet përkatëse pranë Bankës së Shqipërisë (sipas rastit).

Por, Norfund mund edhe ta mbajë Marrëveshjen në fuqi dhe të kërkojë përmbushjen nga HELENOS të detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes, dhe mund të përdorë të gjitha mjetet që ka në dispozicion sipas ligjit për të ushtruar të drejtat e tij që i burojnë nga kjo Marrëveshje.

- 2.3 Palët bien dakord se pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, do të ndërmarrin veprimet dhe hapat e mëposhtme, sipas rendit të mëposhtëm, me qëllim që të përmbushin dhe realizojnë plotësisht qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:
 - 2.3.1 Shoqëria do të (i) bëjë çdo njoftim që duhet bërë pranë Bankës së Shqipërisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit në lidhje me transferimin e kuotave nga Norfund tek HELENOS dhe do të aplikojë për miratimet rregullatore që mund të nevojiten për këtë qëllim (nëse ka), si dhe (ii) do të njoftojë HELENOS pas kryerjes së njoftimit ose miratimit rregullator (nëse ka). Palët bien dakord se nëse

Banka e Shqipërisë për çfarëdolloj arsye nuk e miraton këtë transferim kuotash tek HELENOS, atëherë kjo Marrëveshje bëhet automatikisht e pavlefshme, pa qenë nevoja për njoftim nga Palët, dhe pa pasur Palët të drejtën për të kërkuar likuidim dëmi të çfarëdolloj natyre, dhe/ose rimbursim të kostove në lidhje me transaksionin dhe përcaktimet e kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast zbatohen përkatësisht dispozitat e nenit 2.2.1 të kësaj Marrëveshjeje

- 2.3.2 HELENOS e paguan ~~Çmimin~~ brenda afatit maksimal të përcaktuar në nenin 2.2 të kësaj Marrëveshjeje. Afatet e detajuara dhe mënyra e pagesës së Çmimit do të dakordësohen veçmas mes Norfund dhe HELENOS;
- 2.3.3 Shoqëria do të ndërmarrë menjëherë të gjitha veprimet e nevojshme për të regjistruar transferimin e kuotave nga Norfund tek HELENOS pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe i jepet HELENOS provat se ky regjistrim është kryer.

3. Deklarimet dhe Garancitë

3.1 Shoqëria deklaron dhe garanton si më poshtë:

- 3.1.1 Kjo Marrëveshje është nënshkruar rregullisht nga Shoqëria dhe përbën detyrime të vlefshme dhe ligjërishit detyruese për Shoqërinë, të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj, dhe Shoqëria ka marrë të gjitha miratimet e nevojshme për qëllime të realizimit të këtij transaksioni;
- 3.1.2 Nënshkrimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nga Shoqëria, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të dhe realizimi i transaksionit të përcaktuar në këtë Marrëveshje nuk përbëjnë dhe nuk do të përbëjnë në asnjë aspekt material shkelje ose mospërbushje dhe nuk krijojnë e as nuk do të krijojnë një situatë faktike që pas njoftimit dhe/ose me kalimin e kohës do të rezultonte në shkelje ose mospërbushje dhe nuk bien dhe nuk do të bien ndesh me dispozitat e dokumenteve themeluese të Shoqërisë ose me kontrata, marrëveshje apo instrumente të tjera në të cilat Shoqëria është palë ose ka detyrime kontraktuale; ose me ligjin e zbatueshëm ndaj Shoqërisë;
- 3.1.3 Shoqëria respekton të gjitha aktet ligjore e nënligjore sipas të drejtës shqiptare, sidomos ato që lidhen me mbrojtjen mjedisore e sociale (ESG), Bankën e Shqipërisë dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor të zbatueshëm;
- 3.1.4 Kuotat e Norfund janë të lira nga çdo garanci, peng, barrë, përparësi, çdo e drejtë mbajtjeje, tarifë, pretendim ose çdo e drejtë tjetër që mund të ndikojë në titullin e plotë ligjor dhe të drejtat e HELENOS, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;



- 3.1.5 Otakët Ekzistues kanë hequr dorë nga të gjitha të drejtat e parablerjes vetëm në lidhje me transaksionin që buron nga kjo Marrëveshje;
- 3.1.6 Shoqëria i ka dhënë informacione të plota dhe të sakta HELENOS në lidhje me transaksionin që buron nga kjo Marrëveshje.

3.2 HELENOS deklaron dhe garanton si më poshtë:

- 3.2.1 Kjo Marrëveshje është nënshkruar rregullisht nga HELENOS dhe përbën detyrime të vlefshme dhe ligjrisht detyruese për HELENOS, të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj, dhe HELENOS ka marrë të gjitha miratimet e nevojshme për qëllime të realizimit të këtij transaksioni;
- 3.2.2 Nënshkrimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nga HELENOS, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të dhe realizimi i transaksionit të përcaktuar në këtë Marrëveshje nuk përbëjnë dhe nuk do të përbëjnë në asnjë aspekt material shkelje ose mospërbushje dhe nuk krijojnë e as nuk do të krijojnë një situatë faktike që pas njoftimit dhe/ose me kalimin e kohës do të rezultonte në shkelje ose mospërbushje dhe nuk bien dhe nuk do të bien ndesh me dispozitat e dokumenteve themeluese të HELENOS ose me kontrata, marrëveshje apo instrumente të tjera në të cilat HELENOS është palë ose ka detyrime kontraktuale; ose me ligjin e zbatueshëm ndaj HELENOS;
- 3.2.3 HELENOS, në pozitën e ortakut të ri të Shoqërisë, njeh dhe pranon të gjitha termat dhe kushtet e Statutit të institucionit financiar jo-bankë "Crimson Finance Fund Albania" Shpk dhe të gjitha aktet/dokumentet ligjore dhe rregulloret në fuqi të Shoqërisë;
- 3.2.4 Çmimi i paguar nga HELENOS nuk është produkt i pastrimit të parave ose i lidhur me financimin e terrorizmit dhe HELENOS përmbush kriteret e përshtatshmërisë në lidhje me kërkesat ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- 3.2.5 HELENOS respekton të gjitha aktet ligjore e nënligjore në të gjitha juridiksionet përkatëse, sidomos ato që lidhen me mbrojtjen mjedisore e sociale (ESG), Bankën e Shqipërisë dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor të zbatueshëm;
- 3.2.6 HELENOS i ka dhënë informacione të plota dhe të sakta Shoqërisë në lidhje me transaksionin që buron nga kjo Marrëveshje.

3.3 Norfund deklaron dhe garanton si më poshtë:

- 3.3.1 Kjo Marrëveshje është nënshkruar rregullisht nga Norfund dhe përbën detyrimet e vlefshme dhe ligjore të Norfund, të zbatueshme në

përputhje me kushtet e saj dhe Norfund ka marrë të gjitha miratimet e nevojshme për qëllime të realizimit të këtij transaksioni;

- 3.3.2 Kuotat e Norfund janë të lira nga çdo garanci, peng, barrë, përparësi, çdo e drejtë mbajtjeje, tarifë, pretendim ose çdo e drejtë tjetër që mund të ndikojë në titullin e plotë ligjor dhe të drejtat e HELENOS, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;
- 3.3.3 Nënshkrimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nga Norfund, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të dhe realizimi i transaksionit të përcaktuar në këtë Marrëveshje nuk përbëjnë dhe nuk do të përbëjnë në asnjë aspekt material shkelje ose mospërbushje dhe nuk krijojnë e as nuk do të krijojnë një situatë faktike që pas njoftimit dhe/ose me kalimin e kohës do të rezultonte në shkelje ose mospërbushje dhe nuk bien dhe nuk do të bien ndesh me dispozitat e dokumenteve themeluese të Norfund ose me kontrata, marrëveshje apo instrumente të tjera në të cilat Norfund është palë ose ka detyrime kontraktuale, në mënyrë që të ndikojë në vlefshmërinë e detyrimeve të Norfund sipas kësaj Marrëveshjeje; ose me ligjin e zbatueshëm ndaj Norfund;
- 3.3.4 Norfund respekton të gjitha aktet ligjore e nënligjore në lidhje me zotërimin nga Norfund të Kuotave të Norfund, sidomos ato që lidhen me mbrojtjen mjedisore e sociale (ESG), Bankën e Shqipërisë dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor të zbatueshëm;
- 3.3.5 Norfund i ka dhënë informacione të plota dhe të sakta Shoqërisë në lidhje me transaksionin që buron nga kjo Marrëveshje.

4. Të ndryshme

- 5.1 Nëse lind nevoja për dërgimin e njoftimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, këto njoftime duhet të bëhen me shkrim dhe të dërgohen me postë rekomandë ose të dorëzohen personalisht ose të përcillen me email në adresat e përcaktuara më poshtë. Nëse njoftimi dërgohet me postë rekomandë, ai do të konsiderohet si i marrë tre (3) ditë pune pas datës në të cilën është postuar, përveç nëse vërtetohet se është marrë më herët. Në rast se dërgohet me korrier ose dorazi, ky njoftim do të konsiderohet i marrë në po të njëjtën ditë.

Në lidhje me Norfund:

Fridtjof Nansens plass 4 0160

Oslo

Norway

Në vëmendje të: Marianne Halvorsen, ⁷marianne.halvorsen@norfund.no

Për dijeni: Jo Lochen, jo.lochen@norfund.no



Në lidhje me HELENOS:

Avenue Jules Cesar 2 box 7 - 1150 Brussels -Belgium Në
vëmendje të: Nicolas Blondeau, Administrator
nicolas.blondeau@inpulse.coop

Për dijeni: Izabela Norek, Menaxhere e Investimeve
izabela.norek@inpulse.coop
reporting.helenos@inpulse.coop

Në lidhje me Shoqërinë:

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k., Rruga "Bardhok Biba", Gd. Vjetër Tiranë,
Hyrja I, Kati 2, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Dorin Rama, Drejtor Ekzekutiv

Dorin.rama@crimsoncapital.org

- 5.2 Të gjitha dokumentet që duhet të dorëzohen ose komunikimet që duhet të jepen sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze ose, nëse janë në gjuhë tjetër, duhet të shoqërohen me përkthimin në anglisht, përkthim i cili do të jetë versioni mbizotërues mes Palëve.
- 5.3 Kjo Marrëveshje rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje, divergjencë ose pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ose shkeljen, zgjidhjen apo vlefshmërinë e saj, do të zgjidhet nga arbitrazhi në Oslo, në përputhje me Rregullat e Institutit të Arbitrazhit dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të Dhomës së Tregtisë së Oslos, që janë në fuqi në momentin përkatës.
- 5.4 Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje identike, ku secila do të konsiderohet si origjinale dhe e zbatueshme ndaj Palëve që e kanë nënshkruar atë, dhe të gjitha së bashku përbëjnë një dhe të vetmin dokument.
- 5.5 Kjo Marrëveshje nënshkruhet në gjuhën angleze dhe shoqërohet nga përkthimi në gjuhën shqipe. Versioni në gjuhën angleze përbën versionin detyrues mes Palëve.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët e kësaj Marrëveshjeje, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të tyre në datën e shënuar në fillim të saj.

Fondi Norvegjez i Investimit për Vendet në Zhvillim

Përfaqësuar ligjërisht nga
Marianne Halversen
Menaxhere e Investimeve

HELENOS

Përfaqësuar ligjërisht nga
Znj. Laurence Chambrey, spouse May
Menaxhere e Riskut dhe Pajtueshmërisë

Nicolas Blondeau
Administrator

"CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA" SHPK
CEO dhe Administrator
Z. Dorin Rama

11

REPUBLICAN PARTY

**RËPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LORIANA A. ROBO**



V2022050250304344310

**DATE 14/07/2022
NR REP 3652**

VËRTETIM PËRKTHIMI



Sot, më datë 14.07.2021, para meje Noterit LORIANA A. ROBO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

PËRKTHYESI:

Daniela Demiri, atësia Myzafer, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë 1001 Njesia Bashkiake Nr. 10 Myslym Shyri 124/2 2 27, lindur më 23/11/1983, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 025734119 dhe nr. personal I36123030B.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “Marreveshje per Transferimin e Aksioneve nepermjet Fondit Norvegjez te Investimit per Vendet ne Zhvillim dhe Helenos ne lidhje me Crimson Finance Fund Albania Shpk”, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e përkthyesit.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
LORIANA A. ROBO**



